**Formular për SYLLABUS të lëndës**

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | Fakulteti i shkencave matematike -natyrore |
| **Titulli i lëndës:** | Mikroekonomia |
| **Niveli:** | Bachelor |
| **Statusi lëndës:** | Obligative |
| **Viti i studimeve:** | II |
| **Numri i orëve në javë:** | 3+2 |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | 5 |
| **Koha / lokacioni:** | |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | Ejup Fejza |
| **E-mail adresa:** | ejup.fejza@uni-pr.edu |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës:** | Kjo lëndë do t‟i njoftojë studentët me bazat e teorisë mikroekonomike, si degë e ekonomiksit. Përqendrimi do të jetë mbi zgjedhjet dhe vendimet të cilat i marrin individët dhe firmat në kushte të resurseve të kufizuara. Vëmendje e veçantë do t‟i kushtohet çështjeve si vijon: Kufiri i mundësive të prodhimit, kostot oportune, pamjaftueshmëria dhe efikasiteti; Kërkesa, oferta dhe ekuilibri i tregut; Elasticiteti i kërkesës dhe i ofertës; Sjellja konsumatore; Firma dhe objektivat e saj; Teoria e prodhimit dhe produktit margjinal; Kostoja e prodhimit; Konkurrenca e plotë; Monopoli; Format tjera të konkurrencës jo të plotë: Konkurrenca monopolistike dhe Oligopoli; Shpërndarja e të ardhurave dhe tregu i faktorëve të prodhimit; Sektori publik |
| **Qëllimet e lëndës:** | • të njoftojë studentët me konceptet bazë mikroekonomike;<br>• të nxit të kuptuarit e vendim-marrjes ekonomike dhe faktorëve lidhur me këtë, si analiza margjinale dhe kostot oportune;<br>• të kuptojnë natyrën dhe funksionimin e tregut të produkteve;<br>• të kuptojnë natyrën dhe funksionimin e tregut të faktorëve;<br>• të mësojnë lidhur me “dështimet” e tregut dhe përse shteti ndërhyn në jetën ekonomike;<br>• të mësohen se si të ndërtojnë, të emërtojnë dhe të interpretojnë grafikët dhe diagramet si dhe të dhënat, për të përshkruar apo shpjeguar konceptet ekonomike;<br>• të njihen me „mënyrën ekonomike të të menduarit. |

| | |
|---|---|
| | njohurive teorike të arritura. |
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të:<br>• interpretojnë kuptimin e koncepteve ekonomike si pamjaftueshmëria, kostoja oportune dhe analiza margjinale;<br>• kuptojnë rëndësinë dhe rolin e çmimeve në ekonominë e tregut;<br>• përdorin konceptin e elasticitetit të kërkesës dhe ofertës për vlerësimin kuantitativ të situatave ekonomike;<br>• kuptojnë kostot e prodhimit të firmës, të prezantojnë këto kosto ne formë të lakoreve (kurbave) dhe t‟i komentojnë ato;<br>• shpjegojnë dhe të prezantojnë grafikisht se si firmat marrin vendime ne përcaktimin e çmimeve apo sasisë së prodhimit, në secilën prej strukturave të tregut;<br>• të shpjegojnë "dështimin" e tregut dhe rolin e qeverisë;<br>• të dëshmojnë aftësinë e ofrimit të zgjidhjeve për problemet e ndryshme ekonomike |
| | |
| | |
| **Metodat e vlerësimit:** | *Në përputhje me statutin e UP-së 'Hasan Prishtina'* |
| **Literatura** | |
| **Literatura bazë:** | • Ahmet Mançellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Qirici, "Hyrje në Ekonomi", Shtëpia Botuese "PEGI", Tiranë, 2003. |
| **Literatura shtesë:** | • John Sloman, "Economics", fifth edition, 2003. Pindyck & Rubinfeld (2009) Microeconomics. 7th edition. Prentice Hall.<br>• Wiliam Boyes & Michael Melvi, "Microeconomics", fifth edition, 2002.<br>• ‟Parimet e Mikroekonomis‟ Ramiz Livoreka 2012 Botimi i parë,<br>• Paul A. Samuelson & William D. Nordhaus, |
| **Plani i detajuar i mësimit** | |
| **Java** | **Temat** |

| | |
|---|---|
| *Java 1:* | **Hyrje -Një vështrim i përgjithshëm mbi shkencën ekonomike**<br>▪ Kuptimi i ekonomiksit<br>▪ Kufiri i mundësive të prodhimit dhe kostoja oportune<br>▪ Pamje e përgjithshme e ekonomisë së tregut<br>▪ Përse është e nevojshme njohja e Ekonomiksit<br>▪ Metodologjia e shkencës ekonomike |
| *Java 2:* | **Kërkesa, oferta dhe ekuilibri i tregut**<br>▪ Kërkesa dhe kurba e kërkesës<br>▪ Oferta dhe kurba e ofertës<br>▪ Ekuilibri i tregut dhe Disekuilibr |
| *Java 3*: | **Elasticiteti i kërkesës dhe ofertës**<br>▪ Elasticiteti i kërkesës lidhur me çmimin<br>▪ Faktorët që përcaktojnë elasticitetin e kërkesës lidhur me |
| *Java 4:* | **Zgjedhja konsumatore dhe kërkesa**<br>▪ Zgjedhja racionale dhe vendimet e konsumatorit<br>▪ Dobia marxhinale dhe kërkesa e konsumatorit Zgjedhja konsumatore dhe ligji i kërkesës |
| *Java 5:* | **Firma dhe objektivat e saj**<br>▪ Llojet e firmave<br>▪ Rrugët e rritjes së kapitalit nga firmat<br>▪ Kontabiliteti i firmës.Bilanci dhe pasqyra e rezultatit financiar. |
| *Java 6:* | **Teoria e prodhimit dhe produktit marxhinal**<br>▪ Funksioni i prodhimit në periudha afatshkurtra<br>▪ Ligji i të ardhurave zbritëse |
| *Java 7:* | **Kostoja**<br>▪ Kostot në periudha afatshkurtra<br>▪ Kostoja oportune<br>▪ Kostoja në periudha afatgjata |
| *Java 8:* | Testi I pare semestral |
| *Java 9*: | ▪ Vendimet dhe oferta e firmës në një periudhë afatshkurtër |
| *Java 10*: | **Oferta dhe përcaktimi i çmimeve në konkurrencë të plotë**<br>▪ Sjellja e firmës dhe e degës në periudha afatgjata<br>▪ Konkurrenca e plotë dhe efiçenca ekonomike |

| | |
|---|---|
| ***Java 11*:** | **Monopoli**<br>▪ Monopoli dhe tiparet e tij.<br>▪ Kurba e kërkesës dhe maksimizimi i fitimit në firmën monopol<br>▪ Efiçenca në kushtet e monopolit dhe kritika e tij<br>▪ Diskriminimi i çmimeve në kushtet e monopolit.<br>▪ Politikat shtetërore për kontrollin e monopolit. |
| ***Java 12*:** | **Forma të tjera të konkurrencës jo të plotë.**<br>▪ Tiparet e konkurrencës monopolistike<br>▪ Maksimizimi i fitimit për firmën në konkurrencë monopolistike<br>▪ Oligopoli, llojet dhe baza e ekzistencës së tij<br>▪ Modelet të oligopolit |
| ***Java 13*:** | **Shpërndarja e të ardhurave dhe tregu i faktorëve të prodhimit**<br>▪ Bazat teorike të shpërndarjes së të ardhurave<br>▪ Paga si çmim i faktorit punë<br>▪ Renta si çmim i tokës<br>▪ Interesi si çmim i kapitalit |
| ***Java 14*:** | **Sektori publik**<br>▪ Përse është e nevojshme ndërhyrja e shtetit në ekonomi<br>▪ Sektori publik dhe përmasat e tij<br>▪ Financimi i sektorit publik<br>▪ Zgjedhja publike |
| ***Java 15*:** | ▪ Testi I dytë semestral |